



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME

## **MEPJ: Nis shërbimi për pajisje me Pasaportë dhe Kartë ID edhe në Bari**

**2021-01-15 16:11:00**



Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme bën me dije se ka filluar shërbimi për aplikimin për pasaportë edhe Kartë ID, edhe në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Bari.

Duke filluar nga data 15.01.2021, të gjithë qytetarët shqiptarë që jetojnë në rajonet e Puglias, Molises, Basilikatës, Kalabrisë, Sicilisë dhe Sardenjës do të mund të aplikojnë për këtë shërbim në Konsullatën në Bari.

MEPJ njofton se ky shërbim mund të bëhet online përmes platformës e-Albania dhe se qytetarët do të kenë mundësi ta zgjedhin datën dhe orën individualisht. Më pas Konsullata do t'i njoftojë ata përmes një e-maili për të konfirmuar pranimin e aplikimit.